



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 16706 prot.

Vlorë, më 18.10 2024

PROJEKTVENDIM

Nr. ____, Datë __. __. 2024

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.100, DT.29.12.2023
PËR BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2024” i ndryshuar.**

Në bazë të Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, pika 2, 9 pika 1.1 b, 34, 35, 36, 37,40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c , Ligji nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 45, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 44 ; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Menaxhimit të Buxhetit”, Udhëzimi plotësues nr.2 datë 28.02.2024 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2024”, V.K.B nr.100 datë 29.12.2023 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë për Vitin 2024”.VKB nr 29 datë 28.03.2024 i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 91, datë 26.09.2024. Për krijimin e shoqërisë “Vlora Parking”, si dhe relacioni i paraqitur nga administrata e Bashkisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare për kapitalin e shoqërisë të SHA “Vlora Parking”, me vlerë 3,500,000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë,
2. Në zërin investime të Bashkisë me kod programi (4520), do të pakësohet fondi prej 3,500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë si fonde te lira nga prokurimi i rrugës së Drithasit, dhe të shtohet në llogarinë ekonomike(231) me kod programi 1110 në objektin kapitali i shoqërisë “Vlora Parking”.

a) Pakësohen te Investimet me kod Programi (4520)

| | | | | | | |
|----|--------|-----|-----|-----|-----------|-----------|
| G | Titull | Kap | 600 | 601 | 231 | Investime |
| 00 | 4520 | 5 | | | 3,500,000 | |



b) Shtohen te kapitali me kod Programi (1110)

| G | Titull | Kap | 600 | 601 | 231 | Kapitali |
|----|--------|-----|-----|-----|-----------|---------------|
| 00 | 1110 | 5 | | | 3,500,000 | Vlora Parking |

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë .

4.Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në VKM nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika 6.

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 16706 prot.

Vlorë, më 18.10 2024

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN “PËR NJË RISHPËRNDARJE TË FONDIT TË SHPENZIMEVE OPERATIVE TE BASHKISË TË PARASHIKUAR NË VKB NR.100, DT.29.12.2023, PËR BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2024 I NDRYSHUAR ”

Të nderuar Këshilltarë,

Projekt-vendimi që po ju paraqesim për miratim lidhet me formimin e kapitalit të SHA “Vlora Parking”,

Duke marrë parasysh statutin e subjektit “Vlora Parking”, fillimisht kërkohet mbështetja për krijimin e kapitalit.

Në zërin investime të Bashkisë me kod programi (4520), do të pakësohet fondi prej 3,500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë si fonde të lira nga prokurimi i rrugës së Drithasit, dhe të shtohet në llogarinë ekonomike(231) me kod programi 1110 në objektin kapitali i shoqërisë “Vlora Parking”.

Ky fond shtesë nuk do të prekë Buxhetin e Bashkisë pasi do të përdoren fondet e mbetura nga prokurimet me vlerë më të ulët se fondi limit.

KRYETAR
Ermal Dredha

